



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ME JURIDIKSION TË PËRGJITHSHËM**

***LETRA E TË DREJTAVE TË VIKTIMËS***

**JU KENI TË DREJTË:**

- I. Të përfitoni kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;
- II. Të komunikoni në gjuhën tuaj dhe të ndihmoheni nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit në rast se keni aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar;
- III. Të zgjidhni mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitoni ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;
- IV. Të kërkonti në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njiheni me aktet e provat, pa çënuar parimin e sekretit hetimor;
- V. Të kërkonti marrjen e provave, si dhe të parashtroni kërkesa të tjera përpara organit procedues;
- VI. Të informoheni për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimien e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;
- VII. Të njoftoheni për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- VIII. Të bëni ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- IX. Të kërkonti shpërblimin e dëmit dhe të pranoheni si paditës civil në procesin penal;

- X. Të përjashtoheni, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- XI. Të thirreni në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- XII. Të dëgjoheni nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen tuaj si dëshmitar.